



**BASHKIA
TIRANË**

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 30, datë 05.04.2017

PËR

“MIRATIMIN E TREGUESVE EKONOMIKË DHE FINANCIARË TË BASHKISË SË TIRANËS DHE TAVANEVE PËRGATITORE TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM PËR PERIUdhËN 2018-2020”.

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1.1 shkronja “b” dhe pika 1.3, shkronja “c”, nenit 34, pika 6, nenit 40, pika 4, nenit 41, pika 1 dhe pika 2 shkronja “d”, nenit 54 shkronja “dh” dhe nenit 55, pikat 3 dhe 6 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen vendore”; Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 për “Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar); udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 23, datë 22.11.2016 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”; Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 10, datë 28.02.2017 për “Përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2018-2020; Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 10/1, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 84, datë 29.12.2016 për “Miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2017-2019 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2017” (i ndryshuar); Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 59 datë 30.12.2015 për “Sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës” (i ndryshuar), me propozim të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Miratimin e treguesve ekonomikë dhe financiarë të Bashkisë së Tiranës për periudhën 2018-2020, sipas lidhjes nr. 1 pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Miratimin e tavaneve përgatitore të Programit Buxhetor Afatmesëm për periudhën 2018-2020, sipas programeve dhe për çdo njësi shpenzuese, sipas lidhjes nr. 2 pjesë përbërëse të këtij vendimi.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria e Përgjithshme e Projekteve Strategjike, Drejtoria e Përgjithshme e Promovimit të Qytetit, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licensimit, Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Njerëzore, Drejtoria e

Përgjithshme e Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile dhe të gjitha Strukturat dhe Ndërmarrjet në varësi të Bashkisë së Tiranës.

4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI